

EC MA
"NDRYSHJE"

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-8766
Më 16.7.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b dhe g të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës, kryetari i Komunës, më 16 korrik 2013 mori këtë:

AKTVENDIM

I. Miratohet lista e zyrtarëve komunal të emëruar si persona përgjegjës për kategoritë (shërbime) përkatëse në këtë përbërje:

1. Shërbime komunale.....Fejsal Hoti,
2. Konflikt Interesi.....Osman Hajdari,
3. Korrupsion.....Agron Hoxha,
4. Mashtrim.....Ymer Berisha,
5. Zgjedhje.....Ibrahim Krasniqi,
6. Arsim.....Idriz Kryeziu,
7. Shëndetësi.....Hava Berisha,
8. Rrugë.....Fejsal Hoti,
9. Ujësjetës.....Fejsal Hoti,
10. Kanalizim.....Fejsal Hoti,
11. Mbeturina.....Muhamet Bajrami,
12. Urbanizëm.....Muhamet Kurtaj,
13. Siguri.....Fejzullah Berisha,
14. Gjendje Civile.....Ruzhdi Hoxha
15. Raste Sociale.....Reshat Mehmeti.


II. Komisioni nga pika I i këtij Aktvendimi, do të jenë përgjegjës për kategoritë e lartcekura, do të jenë përgjegjës për Sektorin e vet si dhe përgjegjësitë dhe detyrat e veta do t'i ushtrojë në pajtim me ligjin në fuqi.

Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen Drejtoritë Komunale dhe të emëruarit.

Me këtë Aktvendim të njoftohen, Drejtoritë Komunale, të emëruarit, si dhe Arkivi.

Udhëzim juridik: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së tij, Komisionit për Ankesa, në KK Prizren.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-8516
Më 16.7.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 16.7.2013, me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin me elemente të betonit të disa rrugëve lokale dhe kanalizimeve, me participim, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 8.7.2013, për lejimin e ndërtimit me elemente të betonit të disa rrugëve lokale dhe kanalizimeve, me participim, në Komunën e Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për ndërtimin e:

1. Kanalizimit në rr. "Emin Abazi",
2. Rrugës në fshatin Nashec-Lagja Hazeraj,
3. Rrugës "Oso Kuka",
4. Rrugës "Meriman Jakupi",
5. Rrugës "Mbreti Gerik".

Për realizimin e këtyre projekteve, Komuna e Prizrenit do të participojë me 70 % të vlerës së projektit, ndërsa komuniteti me 30 %.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbime Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbime Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-8516

Më 16.7.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 16.7.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e banesave për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës dhe rasteve sociale- rregullimin e infrastrukturës mjedisore për tri objektet e banimit të ndërtuara, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, i datës 25.6.2013, për ndërtimin e banesave për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës dhe rasteve sociale - lejimin e rregullimit të infrastrukturës mjedisore për tri objektet e banimit të ndërtuara, sipas kodit të projektit 87774, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-8767
Më 16.7.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë për lejimin të mjeteve për mbështetje financiare për mjekim të 18 pacientëve, kryetari i Komunës më 16 korrik 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, i datës 11.7.2013, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për mjekim të pacientëve: 1. Sadbera Shala, 2. Remzije Baruti, 3. Shyhrete Sopaj, 4. Nehal Shatri, 5. Fahrije Thaqi, 6. Azemine Raça, 7. Afërdita Meqa, 8. Besim Shehu, 9. Mehreme Sallauka, 10. Faik Nushi, 11. Mensur Hoda, 12. Mirivete Kryeziu, 13. Valdete Zajmi, 14. Aziz Gashi, 15. Ibrahim Krasniqi, 16. Myrvet Gjokolli, 17. Raifa Rustemi dhe 18. Manuella Koni. Për këtë qëllim, lejohen mjetet në lartësi prej 300 € për secilin prej të lartpërmendurve.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Shëndetësisë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.


Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, të lartcekurit, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-8768
Më 16.7.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë të datës 11.7.2013, rreth mbështetjes financiare për trajtim mjekësor për Vjollca Skenerajn, kryetari i Komunës, më 16 korrik 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, i datës 11.7.2013, rreth mbështetjes financiare për trajtim mjekësor për Vjollca Skeneraj, kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve të mjekimit (trajtimit mjekësor), lejohen mjetet e nevojshme financiare në shumën 1000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve dhe atë nga:

- a. Drejtoria e Shëndetësisë lejohen 500 €, dhe
- b. Drejtoria e Administratës lejohen 500 €.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, e lartcekura, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-8769
Më 16.7.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë të datës 11.7.2013, për mbështete financiare për trajtim mjekësor për Xhelil Karavidajn, kryetari i Komunës më 16 korrik 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit, për Xhelil Karavidajn, mjek në shërbimin parësor të Komunës së Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve të mjekimit (trajtimit shëndetësor), lejohen mjetet e nevojshme financiare në shumën prej 1000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-8516
Më 16.7.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 16.7.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e shpalljes së tenderit për subvencionimin e fermerëve të Komunës së Prizrenit me farë të grurit, dhe mori këtë

KONKLUZION


Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i datës 8.7.2013, për lejimin e mjeteve për subvencionimin e fermerëve të Komunës së Prizrenit me farë të grurit (1000 ha), kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave., si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-8770
Më 16.7.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të datës 9.7.2013, për përkrahje financiare të Asociacionit për kulturë, rini e sport "Arena", me qëllim të organizimit të kursi të notit, kryetari i Komunës më 16 korrik 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 9.7.2013, bazuar në kërkesën e Asociacionit për kulturë, rini e sport "Arena" për përkrahje financiare, me qëllim të organizimit të kursi të notit, në të cilin kurs do të mësojnë notin të rinjtë e komunës së Prizrenit. Kursi do të mbahet në muajin gusht 2013 dhe për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën 4000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave dhe shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, Asociacioni "Arena" si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-8771
Më 16.7.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e mjeteve për përkrahjes financiare për Festivalin tradicional të filmit “9/11”, kryetari i Komunës më 16 korrik 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 8.7.2013, për lejimin e mjeteve për përkrahje të pjesshme financiare për Festivalin tradicional të filmit “9/11” - Nine Eleven Dedication Festival, që do të organizohet nga data 8-11 shtator 2013, kështu që për këtë qëllim, lejohen mjete në lartësi prej 10.000 € (dhjetëmijë euro).

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-8772
Më 11.7.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave për lejimin mjeteve financiare për pagesë të trajnimit dhe licencimit për Vlerësues të Pronave të Paluajtshme, të Islam Osmankajt, zyrtar profesional juridik, kryetari i Komunës më 11 korrik 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave për lejimin e mjeteve financiare për pagesë të trajnimit dhe licencimit për Vlerësues të Pronave të Paluajtshme, të Islam Osmankajt, zyrtar profesional juridik, i përzgjedhur nga Bordi Mbikëqyrës për Licencimin dhe Vlerësuesve për Pronat e Paluajtshme për ndjeke të trajnimit dhe licencimit, kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të trajnimit dhe licencimit lejohen mjetet në shumën prej 700 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave.

Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-8773
Më 16.7.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës për aprovimin e participimit në projektin e ShMT "11 Marsi" me GIZ-in gjerman, kryetari i Komunës më 16 korrik 2013, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës i datës 9.7.2013 për lejinin e participimit me mjete financiare në projektin e ShMT "11 Marsi" me GIZ-in gjerman.

Neni 2

Realizimi i projektit është paraparë me kontratën nr. 83146211 të nënshkruar në mes të GIZ-it gjerman dhe ShMT "11 Marsi" në Prizren.

Kontrata parasheh shfrytëzimin e 47.044,70 € prej të cilëve 29.976,30 € janë donacion i GIZ-it dhe 17.068,40 € janë të hyrat vetanake të shkollës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave,.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, GIZ-i, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-8516
Më 16.7.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 16.7.2013 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me material shpenzues dhe ndërtimor për nevojat e ShMT "11 Marsi", dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, i datës 9.7.2013, për lejimin e furnizimit me material shpenzues dhe ndërtimor për ushtrimin e punës praktike të nxënësve dhe instruktorëve të ShMT "11 Marsi" në Prizren nën mbikëqyrje të GIZ-it dhe për renovim të shkollës, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Realizimi i këtij projekti do të bëhet konformë kontratës nr. 83146211 të nënshkruar në mes të GIZ-it gjerman dhe ShMT "11 Marsi" në Prizren

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, GIZ-i gjerman, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-8774
Më 16.7.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e mjeteve për përkrahje financiare për realizimin e Festivalit të filmit dokumentar dhe të shkurtër "DOKUFEST 2013", kryetari i Komunës më 16 korrik 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e mjeteve për përkrahje financiare për realizimin e edicionit të 12-të të festivalit të filmit dokumentar dhe të shkurtër "DOKUFEST 2013", që mbahet në Prizren, kështu që, për këtë qëllim, lejohen mjetet në shumën prej 15.000 € (pesëmbëdhjetëmijë euro).

Çdo shërbim tjetër i ofruar nga ana e Komunës së Prizrenit lidhur me realizimin e festivalit të lartcekur, Komuna e Prizrenit e llogarit si mbështetje financiare dhe e konsideron si donacion për këtë qëllim.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Komunës së Prizrenit.

Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-8775
Më 16.7.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të nënkryetarit të Komunës për Komunitete, rreth lejitimit të mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve lidhur me pritjen e delegacionit të Komunës së Singjanit të Republikës së Turqisë, kryetari i Komunës më 16 korrik 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i nënkryetarit të Komunës për Komunitete për lejitimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve lidhur me pritjen e delegacionit zyrtar të Komunës së Singjanit të Republikës së Turqisë në Komunën e Prizrenit, nga data 17-20 korrik 2013. Kështu që, për këtë qëllim, lejohen mjetet nevojshme financiare për mbulimin e shpenzimeve të delegacionit të lartcekur.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: nënkryetari i Komunës për Komunitete dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.


Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: nënkryetari i Komunës për Komunitete, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-8516
Më 16.7.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 16.7.2013 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës, për lejimin e shpalljes së tenderit për monitorimin e Muzeut Etnologjik dhe objektit të Beledijes, dhe mori këtë


KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, i datës 15.7.2013, për lejimin e monitorimit të Muzeut Etnologjik që gjendet në Shtëpinë e Shehzades dhe objektit të Beledijes që ka të bëjë me sigurimin e këtyre objekteve, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-8516
Më 16.7.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 16.7.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës, për lejimin e shpalljes së tenderit për demolimin dhe ndërtimin e trafos së re në fshatin Zhur, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, i datës 12.7.2013, për lejimin e demolimit dhe ndërtimit të trafos së re në fshatin Zhur, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Demolimi dhe ndërtimi i trafos së lartcekur do të bëhet në bashkëpunim me KEK-un.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, KEK-u, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Mbija

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/011-zyrtar

Më 18.7.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas kërkesës së Naxhije Doçit, për përkrahje financiare për përkthimin e librit “Krimi dhe përdhunimi serb kundër femrës shqiptare në Kosovë 1997-1999”, kryetari i Komunës më 18 korrik 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet kërkesa e Naxhije Doçit, e datës 17.7.2013, për përkrahje financiare për përkthimin nga gjuha shqipe në gjuhën angleze të librit “Krimi dhe përdhunimi serb kundër femrës shqiptare në Kosovë 1997-1999”, kështu që pjesërisht financohet ky projekt, dhe për këtë qëllim, lejohen mjetet në shumën prej 1500 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencione dhe mallra dhe shërbime të Komunës së Prizrenit.

Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja